




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

01. nr. 030/01-138002/17, më 5.6.2017

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Komunës, më 5.6.2017, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për lejimin e udhëtimit të shërbyesve civilë të Komunës së Prishtinës në Republikën e Shqipërisë.
- II. Për udhëtimin e cekur në pikën I të këtij vendimi, ndahet shuma prej 5000 (pesë mijë) €, nga kategoria e subvencioneve.
- III. Mjetet e cekura në pikën II të këtij vendimi, do të shpenzohen për akomodim, fjetje, mëngjes, drekë dhe darkë.
- IV. Transportin për udhëtim të cekur në pikën I të këtij vendimi, do ta sigurojë Këshilli organizativ, me mjetet e siguruar nga participimi i shërbyesve civilë pjesëmarrës në ekskursion.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Drejtorisë së Financave dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë dhe
- Këshillit organizativ.



KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

09.06.2017